

## Takim i Zëvendëskryeministri Ademi me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Çështje Evropiane Lajçak



Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Dr. Arbër Ademi, sot në Bratislavë, realizoi takim me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Çështje Evropiane të Republikës së Sllovakisë, z. Miroslav Lajçak, i cili gjithashtu ka edhe funksionin e kryesuesit të Këshillit të BE-së.

Zëvendëskryeministri Ademi uroi kolegun e tij për marrjen e kryesimit me BE-në nga ana e Sllovakisë dhe i dëshiroi realizim të suksesshëm të qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara. Gjatë takimit, gjithashtu u diskutua edhe bashkëpunimi bilateral mes dy vendeve, si dhe gjendja aktuale politike në vend.

Gjatë bisedës, Zëvendëskryeministri Ademi theksoi se duke pasur parasysh se marrja e

kryesimit me BE-në ndodh në një periudhë të sfidave serioze, të cilat kërkojnë angazhim dhe fokusim më të madh nga ana e institucioneve Evropiane dhe vendeve anëtare, me ç'rast u përmendën Breksit, ngjarjet në Turqi, aktet e fundit terroriste në Nicë të Francës dhe kriza e vazhduar me migrantët, ai potencoi se të njëjtat nuk duhet të ndikojnë në ngadalësimin e procesit të zgjerimit dhe integritit të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

[më shumë](#)

## **Pjesëmarrja e Zëvendëskryeministrit Ademi në mbledhjen joformale të Ministrave për Çështje Evropiane në Bratislavë**



Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi, me ftesë të Presidencës Sllovaqe, mori pjesë në mbledhjen joformale të Ministrave për Çështje Evropiane, të organizuar në kuadër të Këshillit për Çështje të Përgjithshme të Bashkimit Evropian, i cili u mbajt në Bratislavë më 24 dhe 25 korrik 2016. Në takim mori pjesë Komisarit për zgjerim Johanesh Han dhe të gjithë ministrat për çështje evropiane si dhe përfaqësuesit nga vendet kandidatë të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

Kryesuesi në emër të presidencës Sllovaqe, Ivan Korçak, potencoi se zgjerimi mbetet në fokus të Bashkimit Evropian. Komisarit Han theksoi se në proces, gjatë javëve të fundit, ka progres serioz në pothuajse të gjitha vendet e rajonit. Për Maqedoninë, Komisarit Han theksoi se lajmet e mira për arritjen e marrëveshjes duhet tani të materializohen përmes implementimit të plotë të marrëveshjes edhe atë pa prolongim.

Në fillim të fjalës së tij Zëvendëskryeministri Ademi, u falënderua për ftesën për pjesëmarrje në këtë takim joformal, i cili paraqet edhe një konfirmim për përkushtimin dhe mbështetjen e procesit të integritit në BE. Ai ju referua sfidave serioze me të cilat ballafaqohet Bashkimi Evropian në momentin e marrjes së kryesimit nga ana e Sllovakisë, siç janë Brexit, ngjarjet në Turqi, kanosjet terroriste ndaj sigurisë dhe mundësia e eskalimit të krizës së migrantëve. Njëherësh, theksoi se këto do të kërkojnë angazhim dhe fokusim më të madh nga ana e institucioneve Evropiane, por edhe në rrethana të tilla, ai shprehi shpresat që e gjithë kjo do të kontribuojë në konsolidimin e politikave të BE-së, me ndërmarrjen e masave për parandalim të rreziqeve në të ardhmen dhe vazhdimin e politikave të suksesshme, para së gjithash në politikën e zgjerimit të dëshmuar me dekada të tëra. Zëvendëskryeministri Ademi theksoi se nuk duhet të harrohet politika e zgjerimit e cila ndoshta edhe duhet të jetë pjesë e zgjidhjes për këto sfida.

[më shumë](#)

## Fjala e Zëvendëskryeministrit Ademi në prezantimin e prioriteteve të kryesimit të Sllovakisë me BE-në

Zëvendëskryeministri Ademi ambasadorit Bezak uroi marrjen e kryesimit me Bashkimin Evropian nga ana e Sllovakisë dhe ju dëshiroi realizim të suksesshëm të qëllimeve dhe prioriteteve të caktuara.

Gjatë fjalës së tij Zëvendëskryeministri Ademi theksoi se marrja e kryesimit me BE-në nga ana e Sllovakisë ndodh në periudhën e sfidave serioze kur duhet të bëhen përpjekje të veçanta për ta kthyer besimin në projektin e përbashkët Evropian, e cila është e rëndësishë së veçantë për tërë kontinentin.



[më shumë](#)

## Fjala e Zëvendëskryeministrit Ademi në ngjarjen përfundimtare të IPA projektit " rforcim i kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit për ambient jetësor në nivelin lokal "

"Rritja e qëndrueshme dhe mbrojtja e mjedisit jetësor është një nga temat e cila shkakton interes të madh në nivel botëror, dhe është një nga prioritetet kyçë të Bashkimit Evropian, për atë besoj se realizimi i suksesshëm i IPA projektit mundësoi përförçim shtesë në kapacitetet nacionale në vend, dhe me atë edhe në procesin e aderimit", theksoi Ademi.



[më shumë](#)

## TAKIME INSTITUCIONALE



Takim institucional BE me



Takim institucional BE me



Takim institucional BE me

### **Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratë**

Në takim u diskutuan aktivitetet të cilat ndërmerren në fushat me kompetencë të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratë, që janë të lidhura me procesin e integritimit evropian, respektivisht Reformat Urgjente Prioritare, si dhe statusi i projekteve relevante të financuara nga Instrumenti i ndihmës para aderuese (IPA). Gjatë takimit fokus të veçantë iu kushtua aktiviteteve në fushën e reformave të administratës publike dhe lirisë së shprehjes dhe mediave.

[më shumë](#)

### **ministrinë e drejtësisë**

Në takim u diskutuan aktivitetet të cilat ndërmerren në fushat e drejtësisë dhe luftës kundër korrupsionit, por që janë të lidhura me procesin e integritimit evropian, respektivisht Reformat Urgjente Prioritare, si dhe statusi i projekteve relevante të financuara nga Instrumenti i ndihmës para aderuese (IPA).

[më shumë](#)

### **Ministrinë e Punëve të Brendshme**

Aktivitetet që ndërmerren për realizimin e Reformave Urgjente Prioritare në fushën e kompetencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat po ashtu lidhen me procesin e integritimit Evropian, si dhe statusi i projekteve relevante të financuara përmes Instrumentit të ndihmës para aderuese (IPA) ishin temat e takimit të sotëm të tretë me radhë koordinues të Zëvendëskryeministrit të Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane Dr. Arbër Ademi dhe Zëvendëskryeministrit të Qeverisë dhe Ministër i Punëve të Jashtme z. Nikola Poposki me Ministrin e Punëve të Brendshme z. Mitko Çavkov.

[më shumë](#)

## **TAKIME PUNE**



**Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me ambasadorin e**



**Takim i Zëvendëskryeministrit Ademi me ambasadorin**



**Takim i Zëvendëskryeministrit**

## **Slovakisë Bezak**

Zëvendëskryeministri në takim uroi Republikën e Sllovakisë për marrjen e kryesimit me Këshillin e BE-së dhe dëshiroi zbatim të suksesshëm të programit duke pritur se mbështetja e Sllovakisë për integrimin euro-atlantik të Maqedonisë, mbështetjen bilaterale si dhe ajo në kuadër të grupit të Vishegradit do të konfirmohet edhe gjatë kohës së kryesimit, dhe samitit të ardhshëm të NATO-s në Varshavë.

[më shumë](#)

## **grek Janakakis**

Në fillim të takimit, Zëvendëskryeministri Ademi uroi zotin Janakakis për emërimin e tij si ambasador në vendin tonë, duke i dëshiruar mandat të suksesshëm. Ademi theksoi se masat që ndërmerren për ndërtimin e besimit, janë hap i rëndësishëm për promovimin e marrëdhënëve të mira ndërfqinjësore dhe për thellimin e bashkëpunimit bilateral mes dy vendeve, dhe iu referua ngjarjeve pozitive gjatë viteve të fundit, të shënuara përmes vizitave të përfaqësuesve të lartë të dy vendeve, si dhe takimeve teknike në nivel të lartë që realizohen në vazhdimësi, me shpresë se këto praktika, veç më të vendosura për konsultime profesionale lidhur me çështje që kanë të bëjnë me BE-në, do të vazhdojnë edhe më tej.

[më shumë](#)

## **Ademi me Euroambasadorin Orav**

Zëvendëskryeministri Ademi i'u falënderua Euroambasadorit Orav për angazhimin dhe mbështetjen e tij si dhe të Delegacionit me të cilën ai udhëheq. Në veçanti u theksua bashkëpunimi dhe partneriteti që Euroambasadori Orav pati me Sekretariatit për Çështje Evropiane në implementimin e reformave lidhur me BE-në si dhe shfrytëzimin e IPA dhe fondeve tjera Evropiane. Ademi i dëshiroi sukses në detyrën e re me shpresë se edhe më tej do të mbetet mik dhe mbështetës i vendit tonë.

[më shumë](#)

---

**Takime pune të Sekretares Shtetërore Ana Blazhenka**

## Sekretarja shtetërore për vizitë pune ne Poloni

Në kuadër të vizitës së punës në Varshavë, Sekretari shtetëror Ana Blazheska realizoi takim me nënsekretarin shtetëror të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Poloni, z.Paue Horanzhi. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative përmes përdorimit të drejtë të fondeve aderimuese dhe strukture ka qenë tema kryesore e diskutimit gjatë takimit. Ndër të tjera është theksuar se egzistojnë më shumë mënyra të shkëmbimit dhe ndarjes së përvojave ku punohet me përkushtim dhe u shpreh dëshira e ndërsjellë për të thelluar bashkëpunimin e mëtejshëm.



[më shumë](#)

## IPA projekte

### "Forcimi i bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale"

**Financuar nga:** Bashkimi Evropian  
**Qëllimi i projektit:** Forcimi i sundimit të ligjit nëpërmjet përmisimit të zbatimit të standardeve dhe rekomandimeve të Bashkimit Evropian në fushën e lirisë, sigurisë, drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.  
**Shuma e përgjithshme :** 249 500 EUR  
**Përfituesi kryesor:** Ministria e Drejtësisë

[më shumë](#)

### "Futja e masave të reja për IPARD (LEADER dhe shërbimet këshillëdhënëse)"

**Financuar nga:** Bashkimi Evropian  
**Qëllimi i projektit:** Të kontribuohet në menaxhimin efikas dhe efektiv si dhe implementimin e programit IPARD II dhe përgatitjen e vendit përfitues për implementimin e LEADER dhe masat për shërbime këshillëdhënëse.  
**Shuma e përgjithshme:** 908,750 EUR  
**Kohëzgjatja:** 18 muaj  
**Përfituesi kryesor:** Ministria e Bujqësisë, pylltarisë dhe menaxhimit me ujrat dhe Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë

[më shumë](#)

## BE Lajme

- [Komisioni Evropian ka caktuar shef të ri të zyrës qendrore në Lisbonë](#)

- [Komisioni Evropian prezantoi paketë të re për përkrahje të fermerëve në Evropë me vlerë prej 500 milionë euro](#)
- [Bashkimi Evropian i publikoi rezultatet kryesore nga aktivitet e saja, në bashkëpunimin dhe zhvillimin ndërkombëtar](#)

### **A e dini...?**

- [BE-ja renditet ndër prodhuesit kryesorë në botë të produkteve teknologjike siç janë lojrat dhe pajisjet mjekësore](#)
- [Papunësia ndryshon në masë të madhe në BE, nga 4% në Republikën Çeke, nga 24% në Greqi](#)
- [16 milionë çifte "ndërkombëtare" jetojnë në BE, sipas Komisionit Evropian](#)

### **Ditët ndërkombëtare**

- [8 shtator -Dita ndërkombëtare e arsimit](#)
- [15 shtator -Dita ndërkombëtare e demokracisë](#)
- [21 shtator -Dita ndërkombëtare e Pages](#)

**Ju falënderojmë!**